




**OPERATORI I SISTEMIT
TË TRANSMISIONIT
DHE TREGUT
TË KOSOVËS
(KOSTT)**

**PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR
NOMINIMET**



TABELA E PËRMBAJTJES

1.	OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI I ZBATIMIT	3
1.1	OBJEKTIVAT	3
1.2	FUSHËVEPRIMI	3
1.3	Termt e përdorura në këtë procedurë të rregullave të tregut.....	3
1.4	Standardi i skedulimit të ENTSO-E (ESS) dhe platforma e skedulimit MMS	4
2.	ORGANIZIMI I PALËS TREGTARE DHE METODAT E DORËZIMIT.....	4
2.1	Procesi i aplikimit.....	4
2.2	Dorëzimet e nominimeve.....	5
2.3	Orari i nominimeve.....	5
2.4	Parimet e funksionimit të MMS.....	7
3.	PROCESET MMS.....	8
3.1	Proceset e validimit	8
3.2	Përputhja e nominimeve kontraktuale.....	9
3.3	Përdorimi (trajtimi) i nominimeve të dorëzuara nga OT	10
4.	DISPOZITAT E SITUATAVE TË PAPARASHIKUARA	10
4.1	Parimet e situatave të paparashikuara	10
SHTOJCA 1	SHEMBULL I FLETËLLOGARITJES (SPREADSHEET) SË NOMINIMEVE	12
	SHEMBULL I FLETËLLOGARITJES TË NOMINIMEVE PËR NJË TREGTAR NDËRKUFITAR	12
	Udhëzimet e fletëllogaritjes	13
	Shembull i raportimit xml të nominimit.....	13
	Nominimet e jashtme	13
	Nominimet e brendshme	13
	Nominimi i prodhimit.....	14
	Nominimi i konsumit.....	14
SHTOJCA 2	KODET E PËRGJIGJES MMS.....	15
	EKSTRAKT I KODIT TË PËRGJIGJES SË ENTSO-E	15
SHTOJCA 3	DETAJET E KONTAKTIT	16

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 3 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Kjo procedurë e **Rregullave të Tregut** (përfshirë ndryshimet e mëvonshme) është bërë në përputhje me paragrafin **8.1.2** të **Rregullave të Tregut** me shumicë, të përgatitura në përputhje me nenin 23, paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L -085).

PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET

1. OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI I ZBATIMIT

1.1 OBJEKTIVAT

1.1.1 Në përputhje me paragrafët 11.1.1, 11.2.1, 11.5.1 dhe 10.2.1 të **Rregullave të Tregut**, duhet të ekzistojë një procedurë që mbulon **Nominimet fizike**, **Nominimet kontraktuale** dhe **Nominimet ndërkufitare** që do të detajojë përgjegjësitë, metodat dhe efektet e dorëzimit të nominimeve sipas **Rregullave të Tregut**.

1.2 FUSHËVEPRIMI


1.2.1 Kjo **Procedurë e Rregullave të Tregut për nominimet** do të mbulojë:

- a) Përgjegjësitë e **Palëve Tregtare** përkatëse për të dorëzuar **Nominimet Fizike** tek **OT**, metodat dhe efektet e dorëzimit;
- b) Përgjegjësitë e **Palëve Tregtare** për të dorëzuar **Nominimet kontraktuale** tek **OT**, metodat dhe efektet e dorëzimit;
- c) Përgjegjësitë e **Palëve Tregtare** përkatëse për të dorëzuar **Nominimet Ndërkufitare** tek **OT**, metodat dhe efektet e dorëzimit;
- d) Përgjegjësitë e **Bursave të Energjisë** për të dorëzuar **Nominimet Kontraktuale** tek **OT**, metodat dhe efektet e dorëzimit;
- e) Efektet e të gjitha dorëzimeve të **Nominimeve**.

1.3 Termat e përdorura në këtë procedurë të rregullave të tregut

1.3.1 Në këtë **Procedurë të Rregullave të Tregut** do të përdoren termat e mëposhtëm:

- a) **Standardi i skedulimit të ENTSO-E (ESS)** është një standard i përdorur në zonën sinkrone të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL);

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 4 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- b) **Kodi i Identifikimit të Energjisë (EIC)** është një kod standard ENTSO-E i alokuar **Palëve Tregtare** që përdoret për të identifikuar në mënyrë unike çdo **Palë Tregtare** referuar në një **Nominim Fizik** ose në një **Nominim Kontraktual**;
- c) **Platforma e Skedulimit (MMS)** është baza elektronike e të dhënave, sistem komunikimi dhe procesimi për pranimin, validimin dhe ruajtjen e nominimeve të pranuar dhe për kthimin e informacionit përkatës tek **Palët Tregtare**;
- d) **Veb Aplikacioni për Skedulim** është një portal i bazuar në internet për dorëzimin e nominimeve;
- e) **Dorëzimi i nominimit** është një dokument elektronik i ngarkuar në **MMS** nga një **Palë Tregtare**;
- f) Koha më e hershme e dorëzimit është koha kur OT do të fillojë të përpunojë çdo Dorëzim Nominimi të pranuar përpara asaj kohe; ekziston një Kohë më e Hershme e Dorëzimit për Dorëzimet e Nominimeve përpara **Kohës së Mbylljes së Tregut në D-1** dhe një tjetër para **Koha e Mbylljes së Tregut**.

1.3.2 Të gjithë termat e tjerë me shkronja të zeza do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorur në legjislacionin në fuqi ose në licencë sipas rastit.

1.4 Standardi i skedulimit të ENTSO-E (ESS) dhe platforma e skedulimit MMS

1.4.1 Është pranuar se **OT** operon procesin e nominimeve sipas **ESS** duke përdorur procese të përbashkëta që u mundësojnë **Palëve Tregtare** të përdorin sisteme të ngjashme në të gjithë zonën më të gjerë tregtare të Evropës. **Platforma e Skedulimit MMS** përputhet me **ESS** dhe është sistem që përdoret nga **OT** për përpunimin e të gjitha nominimeve.

1.4.2 Të gjitha **Palët Tregtare** do të identifikohen nën sistemin **ESS** sipas **EIC** kodeve të tyre.


1.4.3 Nominimet do të dorëzohen duke përdorur protokollet e komunikimit të **ESS** dhe transferimet e informacionit duhet të konvertohen në atë standard, pavarësisht nga sistemet e komunikimit të brendshëm të zhvilluara nga një **Palë Tregtare** për përdorimin e saj vetanak.

2. ORGANIZIMI I PALËS TREGTARE DHE METODAT E DORËZIMIT

2.1 Procesi i aplikimit

2.1.1 Për të vendosur mënyrën për dorëzimin e nominimeve, secila **Palë Tregtare** duhet të kontaktojë me **OT**, përmes emailit, duke përdorur detajet të kontaktit të dhëna në Shtojca 3 të kësaj procedure.

2.1.2 Pala Tregtare duhet të ketë aderuar në Rregullat e Tregut dhe do t'i dorëzojë tek OT, email adresën(at) të autorizuar për dorëzimin e nominimeve me email dhe/ose do të kërkojë qasje në Veb Aplikacionin për Skedulim.

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 5 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

2.1.3 OT do të sigurojë si më poshtë:

- a) Lejimin e qasjes në **Veb Aplikacionin për Skedulim** (nëse kërkohet);
- b) Njohjen e adresës(ave) të emailit të dorëzuar për autorizim;
- c) Dërgimin e udhëzimeve për dorëzimin e nominimeve nga adresat e autorizuara të emailit në kostt.scheduling@kostt-mms.com duke përfshirë:
 - i) Një mostër të formularit të **Dorëzimit të Nominimit** në MS Excel kryesisht në formën e përcaktuar në Seksionin 0 tek Shtojca 1 e kësaj procedure (aplikacionin SCHEDULE_XML.xlsm); dhe
 - ii) Aplikacionin e arkivuar (Ess.rar) për konvertimin e formularit të **Dorëzimit të Nominimit** në një dokument të formatit të standardizuar .XML

2.2 Dorëzimet e nominimeve

2.2.1 **Dorëzimet e Nominimeve** duhet të bëhen në formatin .XML dhe të transferohet tek **OT** me email nga një e-mail adresë e autorizuar ose nëpërmjet **Veb Aplikacionit për Skedulim**.

2.2.2 Në përputhje me **ESS**, **Dorëzimet e Nominimeve** dhe përgjigjet (njoftimet e pranimit apo konfirmimet) e **OT** do të bëhen në gjuhën angleze.

2.2.3 Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2.2.1 të kësaj procedure, është e nënkuptueshme se **Pala Tregtare** dhe **OT** do të zbatojnë masat e situatave të paparashikuara të përcaktuara në Seksionin 4 të kësaj procedure në rast të pamundësisë për të bërë **Dorëzimet e Nominimeve** në mënyrën e zakonshme për arsye që janë jashtë kontrollit të secilës palë.

2.3 Orari i nominimeve


2.3.1 **OT** do të publikojë një orar të aktiviteteve ditore në faqen e saj të internetit. Orari i nominimeve në tabelën në paragrafin 2.3.2 të kësaj procedure më poshtë mund të ndryshohet për arsye operative dhe kështu **Palët Tregtare** duhet të përshtaten në rast se orari i publikuar në faqen e internetit ka mospërputhje me tabelën e mëposhtme.

2.3.2 Kohët dhe afatet më të hershme për dorëzimet dhe përgjigjet për të gjitha **Nominimet fizike**, **Nominimet Kontraktuale** dhe **Nominimet Ndërkufitare** janë dhënë në tabelën më poshtë.



Tabela 1: Tabela e aktiviteve dhe oraret

Aktiviteti	Pala dorëzuese	Pala pranuese	Koha më e hershme e dorëzimit / Afati i fundit për dorëzim
Dorëzimi më i hershëm për nominimet fillestare			13:00, D-2
Dorëzimi fillestar i Nominimit ndërkufitar . Kufiri: AL<>XK XK<>ME XK<>MK	Tregtari ndërkufitar	OT	08:00, D-1 08:00, D-1 08:00, D-1
Përgjigja fillestare e Nominimit ndërkufitar	OT	Tregtari ndërkufitar	Brenda tridhjetë (30) minutave, por normalisht menjëherë pas dorëzimit fillestar të Nominimit ndërkufitare
Dorëzimi i Nominimit fizik dhe Nominimit kontraktual	Pala tregtare	OT	14:00, D-1
Përgjigja e Nominimit fizik dhe Nominimit kontraktual	OT	Pala tregtare	Brenda tridhjetë (30) minutave, por normalisht menjëherë pas dorëzimit të nominimit
Dorëzimi më i hershëm për Nominim ditor ndërkufitar			10:05, D-1
Dorëzimi i Nominimit ditor ndërkufitar . Kufiri: AL<>XK XK<>ME XK<>MK	Tregtari ndërkufitar	OT	14:00, D-1 14:30, D-1 14:00, D-1
Përgjigja ditore e Nominimit ditor ndërkufitar	OT	Tregtari Ndërkufitar	Brenda tridhjetë (30) minutave, por normalisht menjëherë pas dorëzimit të Nominimit ditor ndërkufitar
Koha më e hershme e dorëzimit për Nominimet kontraktuale dhe Nominimet fizike dhe Nominimet			18:00, D-1

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 7 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Aktiviteti	Pala dorëzuese	Pala pranuese	Koha më e hershme e dorëzimit / Afati i fundit për dorëzim
ndërkufitare brenda ditës për Tregun brenda ditës			
Afati i fundit për Nominimet kontraktuale dhe Nominimet fizike dhe Nominimet e ndërkufitare brenda ditës për Tregun brenda ditës	Pala tregtare	OT	H-1 për orën H

2.3.3 **Nominimet ndërkufitare** mund të dorëzohen në çdo kohë përpara atyre të përcaktuara në tabelën e mësipërme, por për shkak se nominimet e plota nuk mund të vlerësohen përpara marrjes së dokumenteve të të drejtave të transmetimit nga **SEE CAO, OT** do të bëjë të ditur vetëm marrjen e nominimeve të dorëzuara përpara **Kohës së dorëzimit më të hershëm për Dorëzimet e nominimeve** fillestare dhe nuk do të përpunojë në mënyrë aktive dorëzimet e tilla më të hershme përpara asaj kohe.

2.3.4 **OT** do të bëjë të ditur vetëm pranimin e nominimeve të dorëzuara përpara **Kohës më të hershme të dorëzimit për Dorëzimet e nominimeve të tregut një ditë para** dhe nuk do të përpunojë në mënyrë aktive këto dorëzime të hershme përpara asaj kohe.

2.3.5 Afati i përgjigjes së **OT** për **Dorëzimet e nominimeve** të bëra në përputhje me paragrafët 2.3.3 dhe 2.3.4 të kësaj procedure do të jetë 30 minuta pas kohës përkatëse të **Dorëzimit më të hershëm**, por përgjigjet zakonisht do të jenë menjëherë pas dorëzimit.

2.3.6 Tregtari **Ndërkufitar** nuk mund të bëjë **Dorëzime për Nominime për tregun brenda ditës** përpara se dokumenti i të drejtave të transmetimit të jetë i vendosur në platformën MMS.


2.4 Parimet e funksionimit të MMS

2.4.1 **Palët Tregtare** mund të dorëzojnë **Nominime fizike, Nominime kontraktuale dhe Nominime ndërkufitare** në një dokument të vetëm të ngarkuar i cili do të jetë një **Dorëzim Nominimi**. Ky **Dorëzim Nominimi** do të jetë për **ditën** kalendarike D.

2.4.2 **OT** do të përdorë Kodet standarde të **ENTSO-E** për arsyetim për përgjigje. Kodet mund të gjenden në dokumentin *ENTSO-E GENERAL CODE LISTS FOR DATA INTERCHANGE*:

<https://www.entsoe.eu/Documents/EDI/Library/Core/entso-e-code-list-v36r0.pdf>

një ekstrakt i të cilit është dhënë në 0 të kësaj procedure.

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 8 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

2.4.3 **OT** do t'i përgjigjet **Dorëzimeve të Nominimit** duke përdorur të njëjtin medium të komunikimit me të cilin është pranuar **Dorëzimi i Nominimit** (që do të thotë që, për shembull, një **Dorëzim i Nominimit** me email do të marrë përgjigje me email).

2.4.4 Pas pranimit të një **Dorëzimi të Nominimit** fillestar për **Ditën D**, **OT** do t'i përgjigjet **Palës Tregtare** si më poshtë:

- a) Kryen kontrollet e vlefshmërisë për **Dorëzimin e Nominimit** brenda 30 minutave nga pranimi i **Dorëzimit të Nominimit** dhe **Koha më e hershme** përkatëse e **dorëzimit**, por normalisht do ta bëjë këtë menjëherë;
- b) Dorëzon një njoftim (ACK) që do të konfirmojë pranimin (nëse nuk është njoftuar tashmë) dhe do të njofton për pranimin ose mospranimin e nominimit duke përdorur Kodet standarde të përgjigjes sipas **ENTSO-E**. Kjo do të përsëritet sa herë që **OT** pranon një **Dorëzim të Nominimit**;
- c) Mbivendos të dhënat e vjetra me të dhënat e reja të pranuar në një nominim të ri, duke vënë në dukje se të dhënat e reja të Nominimit pritet mbivendosin të dhënat paraprake të paraqitura në rastet kur ka ndryshime ose shtohen fusha shtesë të të dhënave.;
- d) Dorëzon një konfirmim përfundimtar (CNF) në **Kohën e Mbylljes së Tregut D-1** ose, sipas rastit, në **Kohën e Mbylljes së Tregut**.

2.4.5 **Tregtarët Ndërkufitar** mund të dorëzojnë **Nominime** pasuese **Ndërkufitare** në lidhje me **PTR-të** e fituara në ankandet ditore të **SEE CAO**. Proceset e përshkruara në paragrafin 2.4.4 më lart aplikohen edhe për **Nominimet** ditore Ndërkufitare.


3. PROCESET MMS

3.1 Proceset e validimit

3.1.1 Kontrollet e validimit të përmendura në paragrafin 1.1.1a) të kësaj procedure do të jenë specifike për elementet e të dhënave të dorëzuara.

3.1.2 Kur përpunohet një **Dorëzim i Nominimit**, **OT** do të kontrollojë që:

- a) Të gjitha datat janë në intervalet e duhura për ditën që po përpunohet;
- b) Të gjitha EIC-të e referuara janë EIC valide;
- c) Për Nominimet **Fizike** (Lloji i biznesit "A01 – Production"):
 - i) Të gjitha EIC-të e **Sistemeve Matëse** janë të regjistruara në mënyrë valide tek **Palës Tregtare** që dorëzon;

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 9 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- ii) Të gjitha vlerat e të dhënave MW janë më të vogla ose të barabarta me kapacitetin e regjistruar të **Sistemeve Matëse** përkatëse;
- iii) Shuma e **Nominimeve Fizike** është e barabartë me shumën e **Nominimeve Kontraktuale**, **Nominimeve Ndërkufitare** të deklaruara dhe **Nominimeve Kontraktuale** të pranuar nga **PX**;
- d) Për **Nominimet Kontraktuale** (Lloji i biznesit “A02 – Internal Trade “ ”), nuk bëhen kontrole të veçanta të validimit; dhe
- e) Për **Nominimet Ndërkufitare** (Lloji i biznesit “A03 – External trade explicit capacity”), vlerat e të dhënave MW nuk duhet të kalojnë PTR-të e njoftuara tek OT nga SEE CAO për drejtimin përkatës të nominuar të rrjedhës ose, në rastin e Interkonektorëve që nuk shërbehen nga SEE CAO, PTR-të e regjistruara për Tregtari Ndërkufitar tek Interkonektori përkatës në Regjistrin e Kapacitetit Interkonektiv të OST-së.


3.1.3 **OT** do të pajtohet me formatin dhe protokollet e dorëzimit për **Nominimet Kontraktuale** të bëra nga një **PX** në emër të saj dhe palëve kontraktuale të saj dhe se **OT** do të zhvillojë kontroll të validimit për këto **Dorëzime Nominimesh të PX**. Kur një **Palë Tregtare** përfshinë në **Nominimin** e saj **Kontraktual** tregtimin me **PX**, **OT** do të injorojë informacionin e tillë mbi **Dorëzimin e Nominimit të Palës Tregtare** dhe do të përdorë informacionin për të njëjtat tregtime siç jepet në **Dorëzimin e Nominimit të PX**.

3.2 Përputhja e nominimeve kontraktuale

3.2.1 Kur **Dorëzimi i Nominimit të një Pale Tregtare** përfshinë **Nominime Kontraktuale**, **OT** përdor një informacion të tillë për **Barazim Përfundimtar** derisa të jetë pranuar një **Nominim Kontraktual** i validuar që përputhet, nga pala kontraktuale e identifikuar (në përputhje me seksionin 11.2 të **Rregullave të Tregut**) dhe do të dorëzojë një njoftim për secilin nga **Palët Tregtare** kur çdo **Nominim Kontraktual** është pranuar nga pala kontraktuale përkatëse, e cila do të njoftojë nëse informacioni i pranuar nga secila palë është në përputhje me informacionin e pranuar nga pala kontraktuale e saj në lidhje me çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit**.

3.2.2 Në përputhje me paragrafin 11.3.4 të **Rregullave të Tregut** në **Mbylljen e Tregut në D-1** dhe në **Mbylljen e Tregut** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit të Ditës D**, për çdo **Nominim Kontraktual** dhe për çdo **Periodë të Barazimit të Jobalancit** të referuar, me pranimin dhe validimin e **Nominimit Kontraktual** nga pala kontraktuale e identifikuar, **OT** do të veprojë si në vijim:

- a) Nëse vëllimet e njoftuara përputhen, vendosen vëllimet në **Llogaritë e Injektivit**, ose sipas rastit, në **Llogaritë Dalëse të Palëve Tregtare** përkatëse;

	PROCEDURA E RREGULLAVE TË TREGUT PËR NOMINIMET	PR-MO-010
	<i>ver.1.0</i>	<i>Faqe 10 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- b) Nëse vëllimet e njoftuara nuk përputhen, vendoset vëllimi më i ulët i njoftuar në **Llogaritë e Injektimit**, ose sipas rastit, në **Llogaritë Dalëse të Palëve Tregtare** përkatëse;
- c) Nëse shitësi dhe blerësi i identifikuar nuk përputhen (për shembull, nëse të dy e identifikojnë veten si shitës), vendoset zero në **Llogaritë e Injektimit**, ose sipas rastit, në **Llogaritë Dalëse të Palëve Tregtare** përkatëse;
- d) Nëse mungon një palë kontraktuale, vlerat zero merren parasysh në **Llogaritë e Injektimit**, ose sipas rastit, në **Llogaritë e Marrjes së Palëve Tregtare** përkatëse.

3.2.3 **OT** do të njoftoj **Palët Tregtare** përkatëse për veprimet që ka ndërmarrë në përputhje me paragrafin 3.2.2 të kësaj procedure.

3.3 Përdorimi (trajtimi) i nominimeve të dorëzuara nga OT

3.3.1 Sa më shpejtë që të jetë e mundur, **OT** do të njoftojë **OST**-në për të gjithë informacionin e pranuar në lidhje me **Nominimet Fizike** në çdo **Dorëzim Nominimi**, pavarësisht nëse një informacion i tillë është plotësisht i vlefshëm.

3.3.2 Brenda tridhjetë (30) minutave nga afati i fundit për dorëzimin e **Nominimeve** fillestare **Ndërkufitare**, **OT** do të njoftojë **SEE CAO** (ose **OST**-në në rastin e **Interkonektorëve** që nuk shërbehen nga **SEE CAO**) për të gjitha **Nominimet** e pranuar Ndërkufitare të validuara.

3.3.3 Të gjitha informatat (të dhënat) në **Nominimet Kontraktuale** dhe **Nominimet Ndërkufitare** do të përdoren në proceset e **Barazimit Përfundimtar** nga **OT** pas **Ditës D** dhe informatat në **Nominimet Fizike** do të përdoren për llogaritjet në lidhje me **Barazimin Përfundimtar** të operimeve në **Tregun Balancues**.

4. DISPOZITAT E SITUATAVE TË PAPANASHIKUARA

4.1 Parimet e situatave të paparashikuara

4.1.1 Dispozitat e situatave të paparashikuara do të aplikohen vetëm kur bëhet e pamundur për një **Palë Tregtare** të bëjë **Dorëzimin e Nominimit** ose kur **OT** nuk mund të dorëzojë përgjigje dhe konfirmim me metodat të përshkruara në Seksionin 2.1 të kësaj procedure.

4.1.2 **Palët Tregtare** duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të bërë **Dorëzime Nominimi** brenda orarit të përcaktuar në Seksionin 2.3 above të kësaj procedure.

4.1.3 Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 4.1.2:



- a) Informacioni për **Nominimin Fizik** duhet të sigurohet ashtu që OST-ja ta përdorë këtë informacion sa më shpejtë që të jetë e mundur për të mundësuar planifikimin efektiv të sistemit, duke përdorur të gjitha opsionet e mundshme të komunikimit;
- b) Informacioni i **Nominimit Ndërkufitar** duhet të komunikohet brenda afatit të specifikuar duke ditur se **SEE CAO** nuk mund të modifikojë proceset e tij në rast të vështirësive në komunikim, por **OT** dhe **OST** do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të informuar **SEE CAO** për probleme të tilla komunikimi në mënyrë që **SEE CAO** të aplikojë dispozitat e veta për situatat e paparashikuara në lidhje me pranimin e **Nominimeve Ndërkufitare**. Në raste të tilla, **SEE CAO**–s do t'i kërkohet të përdorë **Nominimet Ndërkufitare** të OST-ve homologe, pa kontrolluar për përputhshmërinë e nominimeve, në të cilin rast palët tregtare do të njoftohen për situatën dhe do të njoftohen se në rast të nominimeve të pa harmonizuara , do të mbizotërojnë nominimet e palëve kontraktuale të tyre; dhe
- c) **OT** do të lejojë marrjen me vonesë të **Nominimeve Kontraktuale** duke njohur kërkesat për përdorim të situatave të paparashikuara.

4.1.4 **OT** dhe **Palët Tregtare** bien dakord të bëjnë **Dorëzime të Nominimit** dhe përgjigjet ndaj tyre në një format sa më të ngjashëm, sa më praktik me formatin e procedurave normale të Dorëzimit të Nominimit kur përdorin dispozitat e situatave të paparashikuara, dorëzimet në formatet .XLS, .XLSX ose .XLSb do të jenë të pranueshme në vend të formatit .XML.

4.1.5 **OT** dhe **Palët Tregtare** të prekura bien dakord të përdorin përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur çështjet që çojnë në nevojën për të përdorur dispozitat e situatave të paparashikuara për komunikimet në lidhje me **Dorëzimet e Nominimeve** sa më shpejtë të jetë e mundur.

4.1.6 Sa më shpejtë që të jetë e mundur, **OT** dhe **Pala Tregtare** e prekur bien dakord t'i rikthehen proceseve normale për **Dorëzimet e Nominimeve**.



**PROCEDURA E RREGULLAVE TË
TREGUT PËR NOMINIMET**

PR-MO-010

ver.1.0

Faqe 12 nga 16

Departamenti: Operatori i Tregut

SHTOJCA 1 SHEMBULL I FLETËLLOGARITJES (SPREADSHEET) SË NOMINIMEVE

Shembull i fletëllogaritjes të nominimeve për një Tregtar Ndërkufitar

1	A	B	C	D
1	Account ID:	Account ID	Account ID	001
2	Account Name:	TPS Party SPC Code		
3	Account Type:	Party SPC Code		
4	Account Status:	TPS		
5	Account Code:	TPS		
6	Account Name:	TPS Party SPC Code		
7	Account Type:	Party SPC Code		
8	Account Status:	TPS		
9	Account Code:	TPS		
10	Account Name:	TPS Party SPC Code		
11	Account Type:	Party SPC Code		
12	Account Status:	TPS		
13	Account Code:	TPS		
14	Account Name:	TPS Party SPC Code		
15	Account Type:	Party SPC Code		
16	Account Status:	TPS		
17	Account Code:	TPS		
18	Account Name:	TPS Party SPC Code		
19	Account Type:	Party SPC Code		
20	Account Status:	TPS		
21	Account Code:	TPS		
22	Account Name:	TPS Party SPC Code		
23	Account Type:	Party SPC Code		
24	Account Status:	TPS		
25	Account Code:	TPS		
26	Account Name:	TPS Party SPC Code		
27	Account Type:	Party SPC Code		
28	Account Status:	TPS		
29	Account Code:	TPS		
30	Account Name:	TPS Party SPC Code		
31	Account Type:	Party SPC Code		
32	Account Status:	TPS		
33	Account Code:	TPS		
34	Account Name:	TPS Party SPC Code		
35	Account Type:	Party SPC Code		
36	Account Status:	TPS		
37	Account Code:	TPS		
38	Account Name:	TPS Party SPC Code		
39	Account Type:	Party SPC Code		
40	Account Status:	TPS		
41	Account Code:	TPS		
42	Account Name:	TPS Party SPC Code		
43	Account Type:	Party SPC Code		
44	Account Status:	TPS		
45	Account Code:	TPS		
46	Account Name:	TPS Party SPC Code		
47	Account Type:	Party SPC Code		
48	Account Status:	TPS		
49	Account Code:	TPS		
50	Account Name:	TPS Party SPC Code		
51	Account Type:	Party SPC Code		
52	Account Status:	TPS		
53	Account Code:	TPS		
54	Account Name:	TPS Party SPC Code		
55	Account Type:	Party SPC Code		
56	Account Status:	TPS		
57	Account Code:	TPS		
58	Account Name:	TPS Party SPC Code		
59	Account Type:	Party SPC Code		
60	Account Status:	TPS		
61	Account Code:	TPS		
62	Account Name:	TPS Party SPC Code		
63	Account Type:	Party SPC Code		
64	Account Status:	TPS		
65	Account Code:	TPS		
66	Account Name:	TPS Party SPC Code		
67	Account Type:	Party SPC Code		
68	Account Status:	TPS		
69	Account Code:	TPS		
70	Account Name:	TPS Party SPC Code		
71	Account Type:	Party SPC Code		
72	Account Status:	TPS		
73	Account Code:	TPS		
74	Account Name:	TPS Party SPC Code		
75	Account Type:	Party SPC Code		
76	Account Status:	TPS		
77	Account Code:	TPS		
78	Account Name:	TPS Party SPC Code		
79	Account Type:	Party SPC Code		
80	Account Status:	TPS		
81	Account Code:	TPS		
82	Account Name:	TPS Party SPC Code		
83	Account Type:	Party SPC Code		
84	Account Status:	TPS		
85	Account Code:	TPS		
86	Account Name:	TPS Party SPC Code		
87	Account Type:	Party SPC Code		
88	Account Status:	TPS		
89	Account Code:	TPS		
90	Account Name:	TPS Party SPC Code		
91	Account Type:	Party SPC Code		
92	Account Status:	TPS		
93	Account Code:	TPS		
94	Account Name:	TPS Party SPC Code		
95	Account Type:	Party SPC Code		
96	Account Status:	TPS		
97	Account Code:	TPS		
98	Account Name:	TPS Party SPC Code		
99	Account Type:	Party SPC Code		
100	Account Status:	TPS		



Udhëzimet e fletëllogaritjes

Fletëllogaritja përfshin një fletë pune me udhëzimet e mëposhtme:

Kopjoni skedarin Ess.xlam dhe ruajeni në dosjen e profilit të përdoruesve (në Windows 7 kjo dosje ruhet nën shtegun: C:\Users\Computerusername).

Në celulën B1 në Fletën e Nominimit, duhet të caktohet data për ditën e nominimit.

Në celulën D1, duhet të shënohet shtegu i dosjes ku do të ruani skedarin xml (aktualisht ne e kemi shënuar shtegun në dosjen D dhe nëse nuk e ndryshoni, atëherë skedarët do të ruhen në këtë dosje)

Pasi të keni plotësuar vlerat në celulën B(41-64) dhe C(41-64), klikoni në butonin Export, nga i cili skedari XML do të ruhet në dosjen e dedikuar (p.sh. Dosja D)

Ju duhet të dërgoni skedarin e krijuar XML me e-mail në adresën kostt.scheduling@kostt-mms.com dhe automatikisht do t'ju dërgohet njoftimi (ACK) dhe konfirmimi (CNF) për programin e nominuar

Për më shumë transaksione ju duhet të shtoni kolona të tjera (Timeseries).

SHEMBULL I RAPORTIMIT XML TË NOMINIMIT

Nominimet e Jashtme

<ScheduleTimeSeries>

```
<SendersTimeSeriesIdentification v="TS0001" />
<SendersTimeSeriesVersion v="1" />
<BusinessType v="A03" />
<Product v="8716867000016" />
<ObjectAggregation v="A04" />
<InArea v="10YTSO1" codingScheme="A01" />
<OutArea v="10YTSO2" codingScheme="A01" />
<InParty v="XPARTYEICCODE1" codingScheme="A01" />
<OutParty v="XPARTYEICCODE2" codingScheme="A01" />
<CapacityContractType v="A01" />
<CapacityAgreementIdentification v="Capacity Identification" />
<MeasurementUnit v="MAW" />
<Period>
```

Nominimet e Brendshme

<ScheduleTimeSeries>

```
<SendersTimeSeriesIdentification v="TS0001" />
<SendersTimeSeriesVersion v="1" />
<BusinessType v="A02" />
<Product v="8716867000016" />
```



Departamenti: Operatori i Tregut

```
<ObjectAggregation v="A03" />  
<InArea v="10YTSO1" codingScheme="A01" />  
<OutArea v="10YTSO2" codingScheme="A01" />  
<InParty v=" XPARTYEICCODE1" codingScheme="A01" />  
<OutParty v=" XPARTYEICCODE2" codingScheme="A01" />  
<MeasurementUnit v="MAW" />
```

Nominimi i prodhimit

```
<ScheduleTimeSeries>  
  <SendersTimeSeriesIdentification v="TS0001" />  
  <SendersTimeSeriesVersion v="1" />  
  <BusinessType v="A01" />  
  <Product v="8716867000016" />  
  <ObjectAggregation v="A02" />  
  <InArea v="10Y1001C--00100H" codingScheme="A01" />  
  <MeteringPointIdentification v="ZPARTYEICCODE" codingScheme="A01"/>  
  <InParty v=" XPARTYEICCODE" codingScheme="A01" />  
  <MeasurementUnit v="MAW" />
```

Nominimi i konsumit

```
<ScheduleTimeSeries>  
  <SendersTimeSeriesIdentification v="TS0001" />  
  <SendersTimeSeriesVersion v="1" />  
  <BusinessType v="A04" />  
  <Product v="8716867000016" />  
  <ObjectAggregation v="A03" />  
  <OutArea v="10Y1001C--00100H" codingScheme="A01" />  
  <OutParty v=" XPARTYEICCODE " codingScheme="A01" />  
  <MeasurementUnit v="MAW" />
```



SHTOJCA 2 KODET E PËRGJIGJES MMS

Ekstrakt i Kodit të përgjigjes së ENTSO-E

Nga lista standarde e Kodeve të ENTSO-E, e cila mund të gjendet në seksionin 23 të dokumentit të mëposhtëm: <https://www.entsoe.eu/Documents/EDI/Library/Core/entso-e-code-list-v36r0.pdf> janë zgjedhur disa dhe janë dhënë si në tabelën e mëposhtme:

Kodi i arsyes	Përkufizimi	Përshkrimi/Emri i shfaqur
A01	Message fully accepted	Mesazhi është pranuar plotësisht
A02	Message fully rejected	Mesazhi është refuzuar plotësisht
A03	Message contains errors at the time series level	Mesazhi është pranuar pjesërisht. Është e nevojshme të shikohet të dhënat në nivelin e detajuar. Në llogaritjen e pozicioni final (global) këto të dhëna nuk llogariten
A04	Time interval incorrect	Perioda e Barazimit përfundimtar nuk është sipas kontratës ose sipas koha është e gabuar
A05	Sender without valid contract	Dërguesi nuk ka kontratë aktuale të vlefshme me OST. Për rrjedhojë, mesazhi do të refuzohet plotësisht
A06	Schedule accepted	Nominimi i palës është i pranuar plotësisht
A07	Schedule partially accepted	Nominimi i palës është pranuar pjesërisht
A08	Schedule rejected	Nominimi i palës është refuzuar plotësisht
A09	Time series not matching	Ka mospërputhje në vlerat për period të barazimit përfundimtar.



**PROCEDURA E RREGULLAVE TË
TREGUT PËR NOMINIMET**

PR-MO-010

ver.1.0

Faqe 16 nga 16

Departamenti: Operatori i Tregut

SHTOJCA 3 DETAJET E KONTAKTIT

Personi kontaktues i OT:	Burbuqe Hasani
Email:	burbuqe.hasani@kostt.com , schedule1@kostt.com
Adresa e postës:	KOSTT Rr. Isa Boletini, nr. 39. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës